

## **D E K R E T**

### **“PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE”**

Në mbështetje të neneve 93, 125 pikat 1 e 3, 129, 149/d pika 1, 179 pikat 2 e 12, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 7, 7/a pika 4, 7/b, 8 dhe 86 pika 4, shkronja “c” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi administrova “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë) e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019”, akte këto të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimet nr.132, datë 21.09.2019 dhe 133, datë 21.09.2019; pasi u njoha me të gjithë praktikën dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatët e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance, përcjellë fillimisht nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 553 prot., datë 08.10.2019 dhe plotësuar përfundimisht me shkresën e këtij organi me nr.714 prot, datë 07.11.2019; si dhe pasi vlerësova kandidatët e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance, pas zgjedhjes nga Kuvendi në datën 11.11.2019, të dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim vendosa të,

#### ***D e k r e t o j;***

##### **Neni 1**

Zonja Marsida Xhaferllari emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

##### **Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.Dekretit11350**

**Tiranë, më 13.11.2019**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
ILIR META**

## ARSYET

### “PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURËS TË ZONJËS MARSIDA XHA FERLLARI, PËR T’U EMËRUAR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PËR PLOTËSIMIN E KËSAJ VAKANCE”

#### I. Shpallja e vakancës për aplikim dhe dërgimi i listave për shqyrtim në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi

Presidenti i Republikës, pasi administroi njoftimin nr. 620 prot., datë 25.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet dekretit nr. 11133, datë 04.03.2019, ka vendosur “Shpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vakancë kjo e cila ishte krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të rregullt të zonjës Altina Xhoxhaj në datën 25.05.2019.

Kjo shpallje për aplikim u publikua sipas kërkesave të ligjit që prej datës 04.03.2019 në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe në Fletoren Zyrtare. Gjithashtu, njoftimi ka qenë i publikuar në shtypin e shkruar nga data 7 deri në datën 11 mars 2019, në gazetat “Panorama”, “Gazeta Shqiptare” dhe “Koha Jonë”.

Në përfundim të afatit ligjor të shpalljes dhe administrimit të aplikimeve (25 mars 2019) për plotësimin e kësaj vakance, aplikuan gjithsej 13 kandidatë ku, për secilin prej tyre, është mbajtur një procesverbal për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit që përmbante dosja e aplikimit, të dorëzuar në Institucionin e Presidentit të Republikës.

Menjëherë pas përfundimit të afatit të aplikimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 234 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës është publikuar lista me 13 aplikantë, të cilët kishin shprehur interesin për të konkurruar për plotësimin e kësaj vakance. Në datën 27.03.2019 menjëherë pas publikimit të listës së aplikuesve, kjo e fundit, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës të dorëzuar, iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për verifikim dhe vlerësim sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka kryer verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese dhe, në përfundim të këtij procesi, ka rezultuar se janë lejuar për kandidim dhe kanë ngelur në garë vetëm **4 (katër) kandidatë** nga **13 aplikantë** që shprehën interesin.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën **nr.553 prot., datë 08.10.2019**, administruar me **nr. 3535 prot, datë 08.10.2019**, ka përcjellë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim” dhe “Raportin e Arsyetuar të Renditjes së tyre për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës me

dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019”.

Nga shqyrtimi paraprak i praktikës rezultoi se:

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 132, datë 21.09.2019, ka miratuar “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”;

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 133, datë 21.09.2019, ka miratuar “Raportin për Renditjen e Kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”.

Bashkëlidhur praktikës së dërguar janë përcjellë nga KED-ja vendimet e marra nga ky organ për lejimin e kandidimit, vlerësimin dhe pikëzimin e katër kandidaturave të ngelura në garë. Ndërkohë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka përcjellë, gjithashtu, edhe vendimet e tij për ndalimin nga kandidimi të **5 (pesë) aplikantëve**, si dhe vendimet për përfundimin e procedurës së verifikimit, për shkak të dorëheqjes nga kandidimi të **4 (katër) kandidatëve**.

Sipas vendimit nr.132, datë 21.09.2019, Këshilli ka miratuar “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”, me këtë renditje:

1.	Arta	Vorpsi	89.642	pikë
2.	Fiona	Papajorgji	88.785	pikë
3.	Elsa	Toska	85.428	pikë
4.	Marsida Xhaferllari 82.000 pikë			

Presidenti i Republikës, në shqyrtimin paraprak të kësaj praktike dhe dokumentacionit të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, konstatoi:

– Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, z.Ardian Dvorani në të njëjtën ditë (datë 08.10.2019) me shkresën **nr. 552 prot., datë 08.10.2019**, ka përcjellë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës edhe “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim” dhe “Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, (**vakanca e parë**), e shpallur për aplikim nga Presidenti i Republikës me dekretin **nr.10722, datë 07.02.2018**”. Kjo praktikë i referohet plotësimit të vendit vakant të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të ish-gjyqtarit, Sokol Berberi.

Në këtë mënyrë, rezultoi se Kryetari i KED-së, në të njëjtën datë 08.10.2019, ka realizuar procesin administrativ të dërgimit të listave pranë Presidentit të Republikës për plotësimin e 2 (dy) vakancave njëherazi, gjë kjo që bie ndesh hapur me radhën që dikton Kushtetuta dhe ligji nr.8577/2000.

Nuk rezultoi që KED-ja, në mënyrë kolegjiale, të ketë marrë ndonjë vendim për mënyrën dhe kohën e dërgimit të listave pranë organeve të emërtesës, por ky veprim administrativ është kryer nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili sipas nenit 226 pika 2/e, të ligjit nr.115/2016, ka si funksion vetëm të nënshkruajë aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe t'ia përcjellë ato organit të emërtesës.

I gjendur para kësaj suate të administrimit të dy listave njëherazi, që i përkasin plotësimin (emërimit) të 2 (dy) vakancave të shpallura nga Presidenti i Republikës, me **shkresën nr. 3571 prot., datë 10.10.2019**, Institucioni i Presidentit të Republikës iu drejtua Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me një kërkesë për informacion mbi faktin nëse ky organ (KED-ja) ia kishte përcjellë ose jo Kuvendit të Shqipërisë listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për dy vendet vakante, të shpallura nga Kuvendi në datat 12.02.2018 dhe 04.03.2019.

Në këtë letër Institucioni i Presidentit të Republikës, përveç se kërkoi informacion nga Kryetari i KED-së, i vuri në dijeni atij se dispozitat kushtetuese dhe ligjore diktojnë zbatimin e radhës së emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, rregulla këto që janë thelbësore për t'u respektuar jo vetëm nga ana e Presidentit dhe Kuvendit, por dhe nga ana vetë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), si një detyrim edhe për veprimet administrative fundore të Kryetarit të KED-së, që duhet të realizoheshin nga ky organ.

Presidenti i Republikës vlerësoi se ky verifikim administrativ dhe ky informacion paraprak ishte i domosdoshëm me qëllim që:

**Së pari**, të fillonte sa më parë procesi i plotësimin të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese;

**Së dyti**, ripërtëritja e Gjykatës Kushtetuese me gjyqtarët e rinj, të ndjekë radhën kronologjike të diktuar nga Kushtetuta dhe ligji ku Presidenti i Republikës të emëronte gjyqtarin e parë kushtetues, vetëm pasi Kuvendi të kishte administruar nga KED-ja listën përfundimtare me numrin e nevojshëm të kandidaturave (jo më pak se tre);

**Së treti**, sepse respektimi i kësaj radhe kronologjike të plotësimin, përveç se është detyrim kushtetues, do të shërbejë edhe si rregull bazë për përtëritjen e tyre në të ardhmen.

**Së katërti**, për të ruajtur të pacenuar kushtetutshmërinë dhe mbarëvajtjen e të gjithë këtij procesi, pasi në të gjitha vakancat aktuale për të cilat KED-ja ka zhvilluar procedurën e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, kishte aplikantë, të cilët gjendeshin njëkohësisht në

cilësinë e kandidatit si në vakancat që i përkasin për plotësim Presidentit, ashtu dhe në vakancat që plotësohen nga Kuvendi.

Emërimi eventual i njërit prej aplikantëve në listën e Presidentit, prek domosdoshmërisht edhe numrin e aplikantëve që gjenden në listën/at e Kuvendit.

Duke qenë se Kushtetuta parashikon që Kuvendi duhet të ketë në dispozicion apo administruar 3 (tri) kandidatura për të bërë përzgjedhjen e vet, Presidenti duhej të vihej në kushtet që emërimi i bërë prej tij, të mos cenonte hapësirën vlerësuese të Kuvendit, në përzgjedhjen e tij.

Fakti që të njëjtët aplikantë në numër të kufizuar gjenden edhe në listën e Kuvendit, përveç se nuk ofron një mundësi reale zgjedhjeje për organet e emërtesës (President- Kuvend) komplikon edhe vetë ushtrimin e kompetencës kushtetuese të zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

**Kështu, një përzgjedhje e mundshme dhe e menjëhershme e Presidentit për plotësimin e të dy vakancave, njëherazi, në çastin që sapo administroi listat e aplikantëve, do të sillte praktikisht vendosjen e KED-së në kushtet e pamundësisë faktike për t'i dërguar Kuvendit listat me, së paku tre kandidatë për secilën vakancë, duke sjellë kështu anomali në procesin e plotësimit të dy vakancave që i takojnë për plotësim Kuvendit të Shqipërisë.**

Po kështu, një përzgjedhje dhe emërim nga Presidenti pa ruajtur radhën kronologjike që Kushtetuta dhe ligji përcakton, do të sillte teorikisht deri në pamundësi të Kuvendit për të pasur numrin e nevojshëm të kandidatëve për zgjedhur anëtarët që i takojnë.

**Presidenti, nisur nga ky vlerësim i rrezikut që krijonte kjo çështje kërkoi informacion nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për t'u siguruar që Kuvendi të administronte listat nga KED-ja.**

**Presidenti mbajti këtë qëndrim nisur nga parimi kushtetues i luajalitetit (bashkëpunimit) midis organeve shtetërore dhe nga gjetja e mundësive që Gjykata Kushtetuese të plotësohet sa më parë.**

Në përgjigje të kërkesës së Presidentit të Republikës për informacion, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shkresën **nr. 655 prot., datë 14.10.2019**, informoi Presidentin me një letër me këtë përmbajtje: "... Ditën e sotme, me shkresën nr.653 prot., datë 14.10.2019 dhe me shkresën nr. 654 prot., datë 14.10.2019, KED ka përcjellë dhe ka dorëzuar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

1. Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën **12.02.2018**;

2. Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, **në datën 04.03.2019.**

Pra, nga ky informacion i përcjellë rezultoi: KED-ja në datën **14.10.2019**, (*pra pas 6 ditëve nga dërgimi i dy listave njëherazi pranë Institucionit të Presidentit*), ka realizuar procesin administrativ të dërgimit të listave në Kuvend për plotësimin e të dy vakancave njëherazi, që i përkasin Kuvendit për zgjedhje.

Nga gjithë informacioni i administruar, rezultoi se KED-ja renditjen e kandidatëve dhe krijimin e 4 listave, për të dy institucionet – President i Republikës dhe Kuvend – i ka bërë në mënyrë të njëkohshme, brenda të njëjtës datë 21.09.2019 ku madje, dhe numërtimi i vendimeve të KED-së për miratimin e listave dhe raporteve përfundimtare të vlerësimit është i alternuar sipas radhës së shpalljes dhe plotësimit të vakancave që i përkasin për plotësim Presidentit dhe Kuvendit.

**Ndërkohë, në aktet e dërguara pranë Institucionit të Presidentit të Republikës nuk paraqitet asnjë e dhënë që të shpjegojë arsyet se përse janë dërguar dy lista njëherazi tek Presidenti, apo shkaqet e vonës dhe të dërgimit të dy listave njëherazi me një javë diferencë pranë Kuvendit.**

Ky veprim administrativ i Kryetarit të KED-së nuk respekton as kohën e përpilimit të listave (listat janë miratuar brenda të njëjtës ditë), as radhën e miratimit të tyre (lista e parë e miratuar është e Presidentit, lista e dytë është e Kuvendit, lista e tretë është e Presidentit, dhe lista e katërt është e Kuvendit) dhe as rendin kronologjik të detyrueshëm, që ka caktuar Kushtetuta dhe ligji, për plotësimin e vendeve vakante.

## **II. Parashikimet kushtetuese dhe ligjore për trajtimin e radhës së dërgimit dhe plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.**

Ndryshimet kushtetuese, të realizuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në datat 21-22 korrik 2016, i kushtuan rëndësi të lartë mënyrës sesi do të zgjidheshin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, si dhe mënyrës sesi do të ripërtërihej përbërja e kësaj gjykate. Kushtetuta e Republikës, në nenin 125, pikat 1 dhe 2, parashikon:

*“1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.*

*2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja*

e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë, shpallet i emëruar”.

Ndërkohë, radha përcaktohet në nenin 179, pika 2 të Kushtetutës, si më poshtë:

**“Anëtari i parë për t’u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. **Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.**”**

Ky rregullim ka qenë me shumë rëndësi për kushtetutëbërësin, aq sa, në të njëjtën dispozitë të nenit 179, në pikën 12, paragrafi i fundit, e ka përsëritur sërish këtë rregull, duke saktësuar:

*“12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 136 të Kushtetutës. Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2, të këtij neni, dhe nenit 125 të Kushtetutës”.*

Sipas këtyre dispozitave Kushtetuese, Presidenti i Republikës, nuk mund të emërojë dy gjyqtarë njëherazi, apo dy gjyqtarë njeri pas tjetrit, por vetëm anëtarin e parë, ndërkohë që anëtari i dytë i Gjykatës Kushtetuese duhet të emërohet nga Kuvendi, ndërkohë që anëtari i tretë do të duhej të emërohej aktualisht nga Gjykata e Lartë, nëse gjendja e plotësimit të vendeve vakant do ta mundësonte edhe këtë organ emërtese, aktualisht në vlerësim nga KED-ja.

Ndërkohë që, në kushtet aktuale që paraqitet gjendja e plotësimit të vakancave referuar përcaktimeve kushtetuese, Presidenti i Republikës, pas emërimit të gjyqtarit të parë nuk mund të emëronte gjyqtarin tjetër të Gjykatës Kushtetuese, në plotësim të vakancës tjetër që i përket si organ emërtese, së paku, pa u shprehur më parë Kuvendi i Shqipërisë për zgjedhjen e gjyqtarit të dytë të saj.

Këto rregullime kushtetuese, sa i takon radhës së emërimit/zgjedhjes, kanë gjetur zberthim në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku pasqyrohet me hollësi sesi këto detyrime duhen përmbushur.

**Në nenin 86, pika 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, përcaktohet:**

*“4. Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2022 do të bëhet sipas skemës së parashikuar **më poshtë:***

**a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2016, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.**

b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025.

c) **Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2019, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.**

ç) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2028.

d) **Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë.**

Për të mbrojtur gjithë procesin e emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe për të respektuar radhën e emërimit të tyre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, domosdoshmërisht, në fazën përfundimtare të miratimit dhe dërgimit të listave përfundimtare, **duhej të mbante parasysh dhe të respektonte kërkesat e mësipërme të Kushtetutës dhe ligjit.**

Secili prej organeve të emërtesës President-Kuvend ka në dispozicion 30 ditë për të shqyrtuar dhe për t'u shprehur në lidhje me emërimin/zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas momentit të dërgimit të listave ky afat për Presidentin ka filluar të ecë prej datës 9.10.2019 dhe për Kuvendin prej datës 15.10.2019.

**Lind e nevojshme të evidentohet se ku janë përcaktuar afatet për secilin nga organet e emërtesës? Për Kuvendin e Shqipërisë afati 30-ditor dhe mekanizmi zhblokues nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë gjyqtarin është parashikuar në Kushtetutë, ndërkohë që një afat i tillë nuk ekziston në Kushtetutë për Presidentin e Republikës.**

Situata e krijuar e diktuar nga momenti i dërgimit të listave prej Kryetarit të KED-së do të përkonte me faktin se Presidenti do të duhej të shprehej brenda datës 07.11.2019 për të emëruar dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese njëherazi, **ç'ka përbën ndalim të drejtpërdrejtë nga neni 179, pikat 2, 12 të Kushtetutës dhe nenet 7, 7/b dhe 86, pikat 4/a/c të ligjit nr.8577/2000.**

Kjo gjendje antikushtetutshmërie krijohet, sepse Kuvendi mund të zgjidhte (*ashtu siç dhe ndodhi në realitet*), që ta ushtronte të drejtën e tij, që të votonte për anëtarin e dytë të Gjykatës Kushtetuese, pas datës 7 nëntor, moment ky që përkonte me përfundimin e afatit sipas ligjit për Presidentin e Republikës.

Në këtë mënyrë Kryetari i KED-së me përcjelljen e njëkohshme të listave të kandidatëve për plotësimin e të dy vakancave që i përkasin Presidentit të Republikës, **e vendosi Institucionin e Presidentit të Republikës në vështirësi, duke u përpjekur që të krijojë një gjendje fakti**, ku Presidenti do të duhej të shprehej brenda afatit ligjor 30-ditor (*neni*



7/b, pika 4 e ligjit nr.8577/2000) edhe për emërimin e gjyqtarit tjetër eventualisht përpara se Kuvendi të shprehej për emërimin e **gjyqtarit të dytë kushtetues**.

**Nëse Presidenti i Republikës, do të ndiqte logjikën e diktuar nga procedura administrative e krijuar nga Kryetari i KED-së, atëherë kjo do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8577/2000, sa i takon respektimit të radhës së emërimit të gjyqtarëve kushtetues.**

Për ta thënë edhe më thjeshtë vetëm një shkresë administrative Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përcjelljen e dy listave me kandidatë për dy vakanca njëherazi, provokonte që t'i impononte "një rregull të ri" Presidentit të Republikës, që të shkelte hapur Kushtetutën dhe radhën e emërimit të anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese.

**Kjo manovër ishte e papranueshme për Presidentin e Republikës.**

Respektimi i radhës së përzgjedhjes së përshkruar më sipër diktohet dhe është e lidhur edhe nga një çast tjetër shumë i rëndësishëm procedural.

**Organet e emërtesës (President, Kuvend) e kanë vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, për plotësimin e vakancave që u përkasin atyre për plotësim si organ emërtese, në momente kohore të ndryshme, sipas një radhe kronologjike, e cila duhej respektuar domosdoshmërisht edhe nga KED-ja.**

Kjo radhë kronologjike është e njëjta me radhën kronologjike që kërkon edhe ligji. Konkretisht:

1. Plotësimi i vakancës së krijuar nga përfundimi mandatit të ish-gjyqtarit **Sokol Berberi (2016)**, është shpallur për aplikim nga Presidenti i Republikës me dekretin e datës **07.02.2018** dhe listat e kandidatëve i janë dërguar në KED-së me shkresën **nr. 2668/2 prot, datë 28.02.2018**.

2. Plotësimi i vakancës së krijuar nga përfundimi mandatit të ish-gjyqtarit **Vladimir Kristo (2016)**, është shpallur për aplikim nga Kuvendi i Shqipërisë në datën **12.02.2018** dhe listat e kandidatëve i janë dërguar KED-së me shkresën **nr. 1031/2 prot, datë 25.04.2018**.

3. Plotësimi i vakancës së krijuar nga përfundimi mandatit të ish-gjyqtarës **Altina Xhoxhaj (2019)**, është shpallur për aplikim nga Presidenti i Republikës me dekretin e datës **04.03.2019** dhe listat e kandidatëve i janë dërguar KED-së me shkresën **nr. 930 prot, datë 27.03.2019**.

4. Plotësimi i vakancës së krijuar nga përfundimi mandatit të ish-gjyqtarit **Bashkim Dedja (2019)**, është shpallur për aplikim nga Kuvendi i Shqipërisë në datën **04.03.2019** dhe listat e kandidatëve i janë dërguar KED-së me shkresën **nr. 1446 prot., datë 04.04.2019**.

**III. Emërimi i gjyqtarit të parë të Gjykatës Kushtetuese.**

Në shqyrtim të praktikës së administruar, referuar parashikimeve kushtetuese dhe dispozitave të mësipërme të ligjit nr. 8577/2000, Presidenti i Republikës shqyrtoi praktikën

dhe dokumentacionin e përcjellë në datën 08.10.2019 nga KED-ja, që i përkiste emërimit të gjyqtarit të parë kushtetues dhe, në përfundim, me dekretin **nr. 11313, datë 15.10.2019**, ka emëruar **zotin Besnik Muçi**, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Ky emërim ju njoftua zyrtarisht Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit, Këshillit të Larë Gjqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Në Institucionin e Presidentit të Republikës, në datën 18.10.2019, ora 18:00, në prani të përfaqësuesve të institucioneve të pavarura dhe kushtetuese, ambasadorëve, si dhe përfaqësuese të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u zhvillua ceremonia e betimit para Presidentit të Republikë, Sh.T.Z. Ilir Meta, të anëtarit të parë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarit Besnik Muçi.

Zoti Besnik Muçi pas bërjes së betimit përpara Presidentit të Republikës, në datën 18.10.2019 ka filluar ushtrimin e detyrës dhe të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 129 të Kushtetutës ku citohet se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës, si dhe nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, ku citohet se mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Në këtë mënyrë, Presidenti i Republikës përmbushi pa asnjë vonesë detyrimin kushtetues dhe ligjor për ripërtëritjen e Gjykatës Kushtetuese dhe emërimin e **anëtarit të parë**, të kësaj gjykate, i cili aktualisht ka filluar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

#### **IV. Pezullimi i procesit administrativ të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019.**

Presidenti i Republikës, pas emërimit të **gjyqtarit të parë** të Gjykatës Kushtetuese në datën 15.10.2019 dhe betimit të tij në datën 18.10.2019, sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe gjendjes së vakancave për plotësim ka ndjekur në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimet mbi këtë çështje dhe ka qenë në pritje që Kuvendi i Shqipërisë të tregonte luajalitet dhe të zgjidhte **anëtarin e dytë të Gjykatës Kushtetuese**, përpara datës **7 nëntor 2019** me qëllim që, pas këtij vendimi të Kuvendit, Presidenti të shprehej menjëherë me dekret për emërimin e anëtarit tjetër që i takonte atij si organ emërtese. Përkundrejt kësaj pritshmërie të Presidentit, rezultoi se Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës për shqyrtimin e çështjes, vetëm në datë **5.11.2019** ka miratuar dy raporte për vlerësimin e

kandidaturave për gjyqtar kushtetues, për dy vakancat që i përkisnin Kuvendit për plotësim dhe, së bashku me dokumentacionin, kishte vendosur t'ia përcjellë seancës plenare për votim.

Në këtë moment, sipas praktikës parlamentare, u evidentua qartë se Kuvendi i Shqipërisë, kishte parashikuar se do të shprehej për zgjedhjen e anëtarit/ëve të Gjykatës Kushtetuese, duke shfrytëzuar maksimalisht afatin 30-ditor, që përfundonte në datën 13 nëntor 2019. Ky çast tejkalonte datën 7 nëntor 2019, moment ky që Presidenti do të duhet të shprehej sipas afatit ligjor që kishte filluar të konsumohej nga dërgimi i gabuar i listave nga Kryetari i KED-së në datën 08.10.2019.

**Pra, siç rezulton, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me dërgimin e listave për plotësimin e dy vakancave në të njëjtën kohë në datë, 8.10.2019, në kundërshtim të hapur me kërkesat e Kushtetutës, ka synuar të dhunojë hapur kompetencën kushtetuese të Presidentit të Republikës.**

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet veprimit të tij administrativ **me shkresë nr. 553 prot, datë 08.10.2019**, u përpoq që ta vendoste Presidentin e Republikës përpara një situatë të faktit të kryer që Presidenti të shprehej me dekret në atë moment (brenda datës 7 nëntor) gjë e cila do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të dy dispozitave kushtetuese njëherazi nenit 179, pikat 2 dhe 12 dhe disa dispozitave të ligjit nr. 8577/2000. **Në këtë mënyrë, vetëm një shkresë përcjellëse e Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 553 prot, datë 08.10.2019, rrezikonte të përmbyste të gjithë rregullin kushtetues dhe Presidenti u vendos në pamundësi për të ushtruar kompetencën e tij për të emëruar gjyqtarin tjetër kushtetues, sipas radhës që përcakton Kushtetuta dhe ligji.**

**Për të qenë më e kuptueshme: me veprimet administrative të Kryetarit të KED-së, parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të miratuara me 140 vota të deputetëve të Kuvendit në 21-22 korrik 2016 dhe dispozitat e ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, të votuar me 86 vota të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, po shkeleshin dhe po përmbyseshin me një shkresë të thjeshtë administrative dhe personale të Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.**

**Kjo situatë u vlerësua si një shkelje shumë e rëndë nga Presidenti i Republikës. Në një situatë të tillë ku rrjedhja e afatit 30-ditor për Presidentin e Republikës përcaktohet vetëm në nenin 7/b, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000 dhe jo në Kushtetutë siç përcaktohet për Kuvendin, merr rëndësi respektimi i dispozitave kushtetuese mbi radhën kronologjike të emërimit që ka përcaktuar Kushtetuta (neni 179, pika 2 dhe 12), por që ka qartësuar në mënyrë shteruese edhe vetë ligji nr. 8577/2000.**

**Ky detyrim kushtetues dhe ligjor duhet të zbatohet jo vetëm nga organet e emërtesës, por duhej të ndiqej domosdoshmërisht edhe në veprimet administrative fundore të KED-së.**

Referuar Kushtetutës ku është përcaktuar radha e plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese dhe ligjit nr. 8577/2000, e drejta e secilit institucion për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues brenda një afati **30-ditor**, fillon efektin, **vetëm pasi procedura për plotësimin e vakancës pararendëse të ketë përfunduar ose, së paku, të ketë filluar më parë në kohë.**

Për sa më sipër, me qëllim përtëritjen e rregullt dhe sipas parashikimeve kushtetuese, të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, nisur nga fakti se çdo organ emërtese në këtë rast (Presidenti, Kuvendi) ka në dispozicion 30 ditë kohë, për t'u shprehur në lidhje me emërimin/zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës, siç do të trajtohet hollësisht më poshtë **ka analizuar shkresën nr. 553 prot, datë 08.10.2019 të dërguar nga Kryetari i KED-së, nën dritën e rregullimeve të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA).**

Vërtet dy organet President-Kuvend kanë në dispozicion të njëjtin afat kohor prej 30 ditësh për t'u shprehur respektivisht me emërim/zgjedhje, **por secili prej këtyre organeve këtë afat e ka të përcaktuar në akte të ndryshme ligjore.**

**Kuvendi e ka të përcaktuar afatin 30-ditor drejtpërdrejt në Kushtetutë.**

**Ndërkohë, që Kushtetuta nuk ka të përcaktuar afatin 30-ditor për Presidentin e Republikës dhe as për Gjykatën e Lartë.** Ky afat, për Presidentin është i përcaktuar vetëm në ligj. **Asnjë dispozitë kushtetuese nuk përcakton ndonjë afat dhe as ndonjë mekanizëm zhbllokues për Presidentin e Republikës në procesin e emërimit të gjyqtarëve kushtetues.**

Konkretisht: Kushtetuta në nenin 125, pika 2 parashikon:

*“2. **Kuvendi** zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda **30 ditëve** nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë, shpallet i emëruar”.*

Pra, për Kuvendin e Shqipërisë kushtetutbërësi ka vlerësuar që afati 30-ditor për tu shprehur dhe mekanizmi zhbllokues në rast se Kuvendi nuk arrin të zgjedhë gjyqtarin kushtetues të **jetë i parashikuar drejtpërdrejtë në Kushtetutë, ndërkohë që për Presidentin një gjë e tillë nuk është parashikuar në Kushtetutë.**

Ndërkohë që i njëjti mekanizëm zhbllokues dhe i njëjti afat prej 30 ditësh ekziston edhe për Presidentin, por ai është i caktuar në një akt të një niveli më të ulët se Kushtetuta dhe, konkretisht, në ligjin nr. 8577/2000, neni 7/b, pika 4 ku citohet:

*“ 4. Presidenti brenda 30 ditëve nga marrja e listës prej Këshillit të Emërimeve në Drejtësi emëron gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë, konsiderohet i emëruar”.*

**Nisur nga fakti që afati 30-ditor për Presidentin e Republikës është i përcaktuar vetëm në ligj, natyrshëm kuptohet që brenda këtij afati Presidenti i Republikës, si organ publik kryen brenda këtij afati edhe veprime dhe vendimmarrje të karakterit administrativ, të cilat i paraprijnë vendimmarrjes përfundimtare, që është shprehja me dekret për emërimin e gjyqtarit kushtetues.**

Kjo do të thotë se brenda këtij procesi shqyrtimi si të listave, ashtu dhe të dokumentacionit Presidenti, si çdo organ tjetër publik, duhet apo mund të kryejë disa verifikime dhe vlerësime që hyjnë në sferën e veprimtarisë administrative për të vërtetuar faktin nëse, ekziston ose jo ndonjë pengesë për marrjen e vendimit prej tij, dhe nëse po, **duhet të ndërmarrë të gjitha masat apo vendimet paraprake, të cilat shmangin çdo mundësi që veprimtaria dhe vendimarrja përfundimtare e Presidentit të mos bjerë ndesh me aktet të tjera ligjore apo me Kushtetutën.**

**Veprimtaria administrative paraprake e Presidentit është e lidhur ngushtë edhe me vetë veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, i cili nuk është një organ gjyqësor, por një organ që veprimtarinë e tij e ushtron në kuadër të veprimtarisë së mirëfilltë të një organi kolegjal administrativ, i cili ka për detyrë që gjithë veprimet e tij t'i ketë në funksion dhe për t'i dhënë organeve të emërtesës (*President, Kuvend, Gjykatë e Lartë*) mundësinë që të zgjedhin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, vetëm në respekt të Kushtetutës dhe ligjit për Gjykatën Kushtetuese.**

Në këtë veprimtari administrative të KED-së përfshihen dhe veprimet fundore të Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili ka për detyrë vetëm të përcjellë listat dhe dokumentacionin përkatës pranë organeve të emërtesës, **por duke përlllogaritur mirë radhën që dikton Kushtetuta në emërimin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe afatet që secili institucion ka në dispozicion.**

Referuar sa më sipër, duke marrë në konsideratë përtëritjen e rregullt dhe sipas parashikimeve kushtetuese të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës, **ka analizuar shkresën nr. 553 prot, datë 08.10.2019 të dërguar nga Kryetari i KED-së**, nën dritën e rregullimeve të Kodit të Procedurës Administrative (KPrA) dhe rregullave kushtetuese e ligjore të përshkuara më sipër.

Kjo sepse sipas nenit 3, pika 9 të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA-së), procesi që kryen Presidenti i Republikës, pasi i është paraqitur shkresa përkatëse nga Kryetari i KED-së, është një procedurë e mirëfilltë administrativ. Në këtë dispozitë të KPrA-së citohet:

*“Procedurë administrative është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative”.*

Pikërisht në këtë rast afatet dhe procedura fillojnë të ecin dhe marrin shkas nga çasti që formalisht paraqitet një praktikë dokumentare nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili në rastin konkret nëpërmjet Kryetarit, me aktin administrativ shkresë nr. 553 prot, datë 08.10.2019, ka përcjellë pranë Presidentit të Republikës “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim” dhe ‘Raportin e Arsyetuar të Renditjes së tyre për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019”.

Në vetvete, praktika dokumentare e paraqitur nga Kryetari i KED-së, si veprimtari administrative fundore e saj, merr vlerën e një kërkesë për të filluar këtë procedurë në kuptim të nenit 41 të KPrA-së, në të cilin parashikohet se:

*“Neni 41*

#### ***Fillimi i procedurës administrative***

- 1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë.*
- 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:  
a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës;  
b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik.*
- 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar:  
a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose  
b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë”.*

Në këtë mënyrë, duke qenë se ligji nr. 8577/2000, parashikon fillimin e procedurës me paraqitjen e listës nga Kryetari i KED-së, atëherë shkresa nr. 553 prot, datë 08.10.2019, sipas parashikimeve të nenit 41 të KPrA-së, merr vlerën e një kërkesë për nisjen e procedurave të mësipërme.

Siç u përmend edhe më sipër, në zbatim të nenit 44/2 të KPrA-së, Institucioni i Presidentit, ka shqyrtuar paraprakisht praktikën dokumentare të paraqitur nga ana e KED-së, duke marrë në analizë secilin prej elementeve të parashikuara nga kjo dispozitë apo nga ligje të tjera. Konkretisht, në nenin 44, pika 2, citohet:

“ 2. Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si **kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji** dhe në përfundim:

a) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës;

b) njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm. Në këtë rast organi publik ndihmon në mënyrë aktive palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi pala mund të ankohet sipas procedurës të parashikuar në këtë Kod;

c) njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative para se të vendosë pranimin ose jo të kërkesës. Në këtë rast, organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme”.

Nga verifikimi i këtyre çështjeve dhe pas marrjes së informacionit nga Kryetari i KED-së, me shkresën nr. 655 prot, datë 14.10.2019, rezultoi se e drejta e Presidentit të Republikës për të operuar me përzgjedhjen e një kandidati dhe emërimin e tij si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për vakancën në shqyrtim, **fillon dhe bëhet operative vetëm pasi një organ tjetër, në këtë rast Kuvendi, të shterojë çështjen që ai ka në kompetencë dhe aktualisht në shqyrtim**; pra, zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese që, sipas radhës, i takon ta zgjedhë ky organ.

Vetëm pasi të shterohet dhe të zgjidhet kjo çështje paraprake (pra, emërimi i anëtarit të dytë nga Kuvendi), e cila sipas afatit kushtetues, duhet të përfundojë brenda datës **13 nëntor 2019**, atëherë Presidentit të Republikës **i lind detyrimi dhe mund të ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese për emërimin e anëtarit tjetër të Gjykatës Kushtetuese.**

Në këtë mënyrë, Presidenti arriti në përfundimin se shqyrtimi në themel i propozimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të realizohej, pasi sipas nenit 179, pikat 2 dhe 12 të Kushtetutës, si dhe neneve 7, pika 2 dhe 86, pika 4/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, **ishte radha e Kuvendit të Shqipërisë që të shprehej për zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese.**

Presidenti i Republikës, në ndjekje të procedurave prej tij për të përmbyllur me vendimmarrje këtë proces brenda një afati të përcaktuar në ligj, **konstatoi se ishte përballë një parakushti të nivelit kushtetues që duhej të përmbushej nga një tjetër organ që ishte Kuvendi, në mënyrë që më pas të vijonte procedura e emërimit të gjyqtarit të radhës nga Presidenti.**

Presidenti i Republikës konstatoi: nëse do të vijonte shqyrtimin, atëherë kjo do të përbënte, **veç të tjerash, jo vetëm cenin të dispozitave kushtetuese, por shkelje të drejtpërdrejtë të tyre.**

Gjithashtu, një tjetër fakt i konstatuar përgjatë shqyrtimit administrativ të praktikës dokumentare të komunikuar administrativisht nga Kryetari i KED-së, rezulton se bazuar në nenin 44/2 shkronja "c" të KPrA-së, ishte e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera administrative prej kësaj të fundit (KED), përpara shqyrtimit përfundimtar lidhur me këtë praktikë.

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shkresën e tij përcjellëse **nr. 553 prot, datë 08.10.2019** i vendosi në dispozicion Presidentit të Republikës vetëm aktet e krijuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Për vlerësimin e disa rrethanave, Presidenti i Republikës, në zbatim të nenit 92/h të Kushtetutës dhe nenit 44/2, shkronja "c" të KPrA-së, vlerësoi të domosdoshme plotësimin e praktikës me të gjithë dokumentacionin e administruar e të shqyrtuar nga KED-ja që përmban dosja e kandidimit të secilit prej 4 (katër) kandidatëve të lejuar dhe të listuar nga KED-ja për plotësimin e kësaj vakance.

Vetëm pas plotësimit të kësaj kërkesë, Presidenti i Republikës do të mund të vlerësonte objektivisht listën e kandidatëve në dispozicion, pasi Kuvendi të ishte shprehur për zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese.

Nevoja për të pasur dokumentacionin e plotë në dispozicion ishte parashikuar nga vetë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në faqen 10, paragrafi i parafundit të "Raportit Përfundimtar të Renditjes së Kandidatëve", ku KED-ja është shprehur për vënien në dispozicion të një kopjeje të plotë të dokumentacionit, në rast se kjo do të kërkohej nga Presidenti i Republikës.

Në lidhje me këto konstatime dhe vlerësime të kryera nga Presidenti i Republikës, përgjatë procedurave administrative të ndjekura prej tij, në zbatim të nenit 44/2 shkronja "c" dhe neni 66/1 të KPrA-së, ishte e detyrueshme marrja e një vendimi paraprak nga Presidenti i Republikës.

Në këtë dispozitë të KPrA-së, citohet shprehimisht:

*Neni 66*

### **Çështjet paraprake**

**1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër ("çështja paraprake"), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.**



Pasi u sigurua që Kuvendi i Shqipërisë, deri në datën 05.11.2019, nuk ishte shprehur dhe nuk kishte planifikuar asnjë seancë plenare për të zhvilluar procesin e votimit për zgjedhjen e gjyqtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim ruajtjen e kushtetutshmërisë së këtij procesi; respektimin e parashikimeve kushtetuese të radhës së përzgjedhjes; **me vullnetin e qartë për t'u shprehur për emërimin e gjyqtarit kushtetues**, Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 4, 92, 179, pikat 2, 12 të Kushtetutës, neneve 7, pika 2, 7/b, dhe 86, pika 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe neneve 44/2 shkronja "c" e 66 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", **nëpërmjet Aktit Administrativ nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019, vendosi paraprakisht:**

– Të pezullojë procesin administrativ të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019, përcjellë nga KED-ja me shkresën nr. 553 prot., datë 08.10.2019, **deri në zgjedhjen e anëtarin të dytë të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi i Shqipërisë apo deri në përfundimin e afatit kushtetues, brenda të cilit Kuvendi i Shqipërisë do të shprehet për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e dy vakancave që i përkasin atij si organ emërtese dhe që, sipas përlllogaritjes, ky afat përmbushet në datën 13 nëntor 2019;**

– t'i kërkojë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm plotësimin e praktikës dokumentare dhe dërgimin brenda 5 (pesë) ditëve të kopjes së dokumentacionit të administruar e të shqyrtuar nga KED-ja që përmban dosja e kandidimit e secilit prej 4 (katër) kandidatëve të lejuar dhe të listuar nga KED-ja për plotësimin e vakancës së shpallur nga Presidenti me dekretin nr.11133, datë 04.03.2019 me qëllim vijimin e shqyrtimit;

– të kërkojë bashkëpunimin e Kuvendit të Shqipërisë që të vlerësojë mundësinë për të përfshirë për shqyrtim në seancë plenare, brenda një kohe sa më të shpejtë, zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që Presidenti i Republikës, të ushtrojë kompetencën e tij, sipas radhës së diktuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 8577/2000.

Ky akt iu përcoll menjëherë zyrtarisht për njoftim Kuvendit të Shqipërisë, Avokatit të Popullit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

**Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresë nr. 714 prot, datë 07.11.2019, i është përgjigjur kërkesës së Presidentit të Republikës, duke përcjellë të gjithë praktikën dokumentare të administruar dhe vlerësuar nga KED-ja për të katër kandidatët në listën që i është përcjellë Presidentit të Republikës.**

Ky vendim paraprak me efekt pezullues të vijimit të procesit administrativ të shqyrtimit të listës dhe dokumentacionit të përcjellë nga Kryetari i KED, deri në realizimin e zgjedhjes nga Kuvendi të anëtarit të dytë (datë 13 nëntor 2019), kishte për qëllim, së pari, respektimin e Kushtetutës në procesin e emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të rinj të kësaj Gjykate sipas radhës që dikton Kushtetuta; ruajtjen e të gjithë procesit në tërësi, si dhe të siguronte njëkohësisht afatin e nevojshëm procedural në dispozicion, në mënyrë që Presidenti të ushtronte kompetencën kushtetuese për të zgjedhur anëtarin e radhës të Gjykatës Kushtetuese.

**Siç është bërë publik dhe në vendimin e pezullimit, Presidenti i Republikës, ka shprehur qartë se në cilësinë e organit të emërtesës, Presidenti ka të gjithë vullnetin dhe dëshiron të shprehet për të emëruar anëtarin e radhës të Gjykatës Kushtetuese nga lista e kandidaturave të përcjella nga KED-ja.**

**Shprehja e vullnetit prej Presidentit publikisht se do të zgjedhë me dekret emërimin e gjyqtarit kushtetues dhe akti administrativ nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019, janë akte të cilat tregojnë se mekanizmi zhbllokues në këtë rast, i parashikuar në nenin 7/b, pika 4 të liqjit nr. 8577/2000, nuk mund të aplikohet.**

Presidenti me këtë vendim paraprak ka rregulluar, gjithashtu, një situatë jo të zakonshme të krijuar nga veprimtaria administrative e dërgimit të listave të keqmenduar nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

**V. Efektet e aktit të pezullimi të procesit administrativ të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare, si dhe rifillimi i ecjes së afateve procedurale.**

Akti administrativ nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019, nëpërmjet të cilit Presidenti pezulloi procedurën administrative të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr.11133, datë 04.03.2019, normalisht që sjell edhe efekte sa i takon pezullimit të ecjes së afatit ligjor deri në përmbushjen e kushtit që përbënte dhe shkakun kryesor të pezullimit të procedurës nga Presidenti.

Nëse data 08.10.2019, moment ky kur Kryetari i KED ka përcjellë listën dhe dokumentet shoqëruese në Institucionin e Presidentit të Republikës, do të vlerësohet si momenti fillestar nga i cili duhet të fillojnë të ecin afatet procedurale për Presidentin e Republikës, atëherë deri në datën 05.11.2019, kohë kjo kur Presidenti i Republikës mori vendimin e pezullimit, në zbatim të nenit 56 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton të jetë konsumuar gjithsej 27 (njëzeteshtatë) ditë.

Pra, pasi të bjerë shkak i pezullimit që është momenti që Kuvendi i Shqipërisë me vendim të zgjedh anëtarin e dytë të Gjykatës Kushtetuese, duke përjashtuar edhe këtë ditë si ditë ngjarje, Presidenti i Republikës, ka në dispozicion edhe **3 (tre) ditë** të tjera për të vlerësuar

dhe për t'u shprehur me dekret për emërimin e gjyqtarit të radhës përpara se t'i përfundojë afati 30-ditor në dispozicion.

Nëse momenti kur KED-ja ka përcjellë përfundimisht dokumentet shoqëruese të kërkuara nga Presidenti i Republikës (data 07.11.2019), do të vlerësohet si moment procedural që konsideron një praktikë administrative të plotë ligjërish për t'u shqyrtuar, atëherë ky është dhe momenti që fillon të ecë afati procedural 30-ditor i përcaktuar për Presidentin e Republikës në nenin 7/b, pika 4 të ligjit nr. 8577/2000.

Edhe sikur me keqdashje ta vlerësojmë shkakun e pezullimit të rënë, sërish Presidenti i Republikës, nën këtë logjikë, është brenda afatit për shqyrtimin e praktikës. Referuar këtyre përllogaritjeve të bëra sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe duke marrë për referencë se shkakun i pezullimit ka rënë në datën 11.11.2019, ditë kjo kur Kuvendi i Shqipërisë është shprehur me vendim për emërimin e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese, në të dy variantet e përllogaritura më sipër, Presidenti i Republikës është brenda afatit ligjor për t'u shprehur me dekret.

Kjo sepse, në variantin e parë, Presidentit të Republikës i përfundon afati në datën **14.11.2019** dhe, sipas variantit të dytë, Presidentit të Republikës i përfundon afati në datën **6 dhjetor 2019**.

#### **VI. Veprimtaria dhe vendimmarrja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Kuvendit të Shqipërisë pas nxjerrjes së aktit administrativ nga Presidenti për pezullimin e procesit të shqyrtimit të listave prej tij, si dhe rënia e shkakut të pezullimit**

Siç dhe u trajtua më sipër, **Akti Administrativ nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019 i Presidentit të Republikës që vendosi paraprakisht; "Pezullimin e procesit administrativ të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr.11133, datë 04.03.2019, përcjellë nga KED-ja me shkresën nr. 553 prot., datë 08.10.2019, deri në zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi i Shqipërisë apo deri në përfundimin e afatit kushtetues, brenda të cilit Kuvendi i Shqipërisë do të shprehet për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e dy vakancave që i përkasin atij si organ emërtese dhe që, sipas përllogaritjes, ky afat përbushet në datë 13 nëntor 2019,** iu njoftua menjëherë Kuvendit të Shqipërisë, Avokatit të Popullit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi është njohur me aktin në datën 06.11.2019, nëpërmjet rrugës (postës) elektronike ka njoftuar thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën **07.11.2019, në orën 13.00**, me rend dite "Diskutim mbi qëndrimet e Presidentit të Republikës, lidhur me procesin e plotësimit të

*vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese*". Në këtë mbledhje u thirrën dhe kanë qenë të pranishëm përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Në këtë mbledhje Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u vu në dijeni të qëndrimeve të Presidentit të Republikës të shprehura në shkresën nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019, me lëndë " *Mbi zgjedhjen/emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese sipas radhës që dikton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8577/2000*".

Pas shtrimit për diskutim të qëndrimit të Presidentit, anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje u dakordësuan se nuk mund të komentojnë përmbajtjen e letrës së Presidentit me argumentin se nuk kanë autoritet që ta kryejnë anatemimin e vendimit të Presidentit ku, për më tepër, nëse do ta bënin ata do të përfshihen në ndërhyrje të kompetencave dhe, rrjedhimisht, në një konflikt institucional kompetencash.

Për më tepër, anëtarët evidentuan se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka përmbyllur procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve që prej datës 21 shtator 2019, dhe procedurat e mëpasshme janë procedura administrative. Përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, mbajti në këshill qëndrimin se Presidenti, nëpërmjet vendimit të tij paraprak, shpreh vullnetin se do të shprehet me dekret për emërimin e gjyqtarit kushtetues menjëherë sapo të bjerë kushti i pezullimit që është zgjedhja nga Kuvendi i Shqipërisë të anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë mënyrë, në kushtet kur i ka përfunduar procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për katër vende vakante, dy për secilin organ emërtese, përkatësisht për Presidentin e Republikës dhe Kuvendin, Këshilli në mbledhjen e datës 7.11.2019 pa ndonjë vendimmarrje dakortësoi vetëm që t'i përcillen Institucionit të Presidentit të Republikës kopje të dokumentacionit të administruar dhe të shqyrtuar që përmban dosja e kandidimit të secilës prej 4 kandidatëve të listuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11133 datë 04.03.2019. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk diskutoi asnjë çështje tjetër në këtë mbledhje.

Po në të njëjtën ditë, pas përfundimit të mbledhjes KED-së, me shkresën nr. 714 prot, datë 07.11.2019, KED i është përgjigjur kërkesës së Presidentit të Republikës, duke përcjellë të gjithë praktikën dokumentare të administruar dhe vlerësuar nga KED-ja për të 4 (katër) kandidatët të listuar për plotësimin e vendit vakant nga Presidenti i Republikës.

**Ndërkohë, për çudi, në Fletoren Zyrtare nr. 151, ditë e shtunë, datë 9 nëntor 2019,** është botuar në format elektronik vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 132, datë 21.9.2019 "Për miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në

Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”, pikërisht vendim ky që i është përcjellë Presidentit të Republikës që prej datës 08.10.2019 nga KED-ja.

**Kjo çështje nuk u shtrua dhe as u diskutua në mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datës 7 nëntor 2019.**

Në lidhje me botimin e këtij akti në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë është e nevojshme **të sqarohet fakti se ligji nr.78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare” dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nuk e përcaktojnë këtë lloj vendimi të KED-së, si një akt të botueshëm në Fletoren Zyrtare.**

Neni 3, pika 1 e ligjit nr. 78/2014, përcakton se “Akte të botueshme” janë të gjitha aktet, botimi i të cilave është i detyrueshëm në bazë të Kushtetutës dhe legjisllacionit në fuqi. Në vijim, në po këtë nen, në pikën 5, saktësohet se botimi në Fletoren Zyrtare **është bërja e njohur botërisht, në formë të shkruar dhe elektronike e akteve të botueshme, sipas legjisllacionit në fuqi.**

Ndërkohë, në nenin 6, pika 2 të po këtij ligji, përcaktohet se:

2. Në Fletoren Zyrtare botohen:

- a) ligjet;
- b) dekretet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
- c) aktet normative të Këshillit të Ministrave;
- ç) aktet normative të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore;
- d) vendimet, rezolutat dhe deklaratat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- dh) vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjet që kanë të bëjnë me Shqipërinë;
- e) vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
- ë) vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, të cilat botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare;
- f) të gjitha aktet e tjera, botimi i të cilave është i detyrueshëm sipas legjisllacionit në fuqi;
- g) indeksi vjetor i Fletores Zyrtare.

Ndërkohë që, në nenin 8, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, përcaktohet:

“ 1. Aktet e botueshme, të parashikuara në nenin 6, të këtij ligji, publikohen në Fletoren Zyrtare, vetëm atëherë kur versioni përfundimtar në origjinal i aktit është nënshkruar nga organi **që e ka nxjerrë atë dhe me kërkesën e tij.**

2. Teksti i akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik nga institucionet shtetërore përkatëse që kanë miratuar aktin”.

Ndërkohë, për të shteruar edhe më tej trajtimin ligjor të kësaj çështjeje, është me vend të evidentohet në hollësi, nëse vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi **nr. 132, datë 21.9.2019**, është një nga ato akte që mund të botohet në Fletoren Zyrtare, sipas ligjit të

posaçëm. Kjo situatë gjen rregullim edhe në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” ku në nenin 232 përcaktohet:

*Neni 232*

### **Publikimi i akteve**

1. Lista e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur, e shoqëruar me arsyetimin përkatës për përjashtimin tyre, lista e kandidatëve që vijojnë konkurrimin dhe renditja e tyre **publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.**

2. Të gjitha aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes për secilin kandidat, të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi **bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, të shoqëruara me shpjegimet dhe arsyetimet përkatëse, si dhe me një përmbledhje të procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.**

Për më tepër, edhe vetë vendimi i KED-së nr. 132, datë 21.09.2019 që **rezultoi se u botua pa kuptim dhe në kundërshtim me ligjin në Fletoren Zyrtare, në pikën 2 të tij,** citon shprehimisht:

**“Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.**

Referuar të gjithë bazës ligjore të mësipërme dhe fakteve të konstatuara, rezulton e provuar:

– Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 132, datë 21.9.2019 “Për miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”, **nuk hyn në llojin e atyre akteve të lejueshme për botim në Fletoren Zyrtare;**

– Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është titullar i KED-së dhe sipas ligjit është ai autoriteti përgjegjës për dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare. Me dërgimin e aktit për botim në Qendën e Botimeve Zyrtare **është kryer shkelje e rëndë e ligjit nr.115/2016, gjë për të cilën duhet të fillojnë procedurat disiplinore.** Sipas nenit 226, pika 2/e, Kryetari nënshkruan aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe ia përcjell ato organit të emërtesës, pra Presidentit të Republikës.

Me dërgimin e këtij akti në Institucionin e Presidentit të Republikës në datën 08.10.2019 dhe botimin e vendimit nr. 132, datë 21.09.2019 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kryetari i KED-së e ka përmbushur funksionin e tij.

Çdo veprim tjetër i kryer përtej kërkesave të ligjit dhe pa vendimmarrje të KED-së si organ kolegjal, përfshihet në llojin e veprimeve që përbëjnë **shkak për procedim disiplinor,** sipas nenit 242/dh, të ligjit nr. 115/2016.

– Nëse Kryetari i KED-së, ka vepruar në këtë drejtim, duke dashur të bëjë publike idenë se KED-ja është një organ që konstaton fakte që krijojnë idenë se kandidatë të caktuar janë vetëzgjedhur për efekt të funksionimit mekanizmit zhblllokues që ka ligji, kjo do të rëndonte pozitën e tij përballë procesit disiplinor.

Kjo, sepse këto veprime shërbejnë vetëm për ndërlikimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe trajtimit të çështjes së zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, duke sjellë njëkohësisht humbjen e besimit të publikut tek integriteti i procesit të zgjedhjes të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

– Kjo veprimtari për dërgimin për botim të një akti të Këshillit që sipas ligjit nuk botohet në Fletoren Zyrtare e lidhur edhe me veprimtarinë tjetër antikushtetuese të Kryetarit të KED-së, në dërgimin e listave pranë organeve të emërtesës, krijon bindjen te Presidenti i Republikës, se Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i ka kryer të gjitha këto veprime aspak nga pakujdesia, por me ndërgjegje të plotë, me qëllim vënien përpara faktit të kryer të Presidentit të Republikës, për të kryer një shkelje kushtetuese në procesin e përzgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas një radhe të diktuar nga Kryetari i KED-së dhe që bie në kundërshtim të hapur me parashikimet e kushtetutës.

– Gjithashtu, edhe vetë botimi i vendimit nr. 132, datë 21.09.2019 të KED-së nga Qendra e Botimeve Zyrtare, është **kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit** nr. 78/2014, pasi ky akt nuk është i detyrueshëm për botim në Fletore Zyrtare dhe QBZ-ja duhet të kishte refuzuar botimin e tij.

Edhe pse paligjshmëria e botimit në Fletore Zyrtare, është trajtuar si diçka normale nga organet e përfshira në këtë proces, sërish botimi i tij nuk krijon asnjë pasojë juridike për procesin e emërimit të gjyqtarit Kushtetues nga Presidenti i Republikës.

Kjo, sepse vetë vendimi nr. 132, datë 21.09.2019, ka qenë në fuqi që prej datës kur ai është nxjerrë. Nëse Kryetari i KED-së ka pasur dëshirë të shohë të botuar në Fletoren Zyrtare një akt të nënshkruar prej tij, kjo është realizuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare. Nëse ai ka menduar se me botimin në Fletore Zyrtare, ky vendim merr fuqi juridike, kjo duhet të ishte ndjekur për të gjitha vendimet e tjera.

**Nëse një mendim i tillë do të ishte i bazuar, atëherë i bie që përlllogaritja e afatit 30-ditor për Presidentin do të fillonte nga data e botimit të këtij akti. Do të ishte një absurditet i madh ligjor.**

Ndërkohë, pasi Presidenti i Republikës përcolli pranë Kuvendit të Shqipërisë vendimin e tij të pezullimit, nr.3535/1 prot, datë 05.11.2019, siç rezulton nga praktika parlamentare e

publikuar, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë ka nxjerrë urdhrin nr. 35, datë 7.11.2019, "Për mbledhjen e Kuvendit në Seancë Plenare në datën 11.11.2019".

Sipas rendit të ditës së miratuar në pikën 5 dhe 6 ishin përfshirë dhe dy projektvendime për zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për vakancat e shpallura nga Kuvendi, përkatësisht në datën 12.02.2018 dhe 04.03.2019.

Sipas këtij akti, rezultoi e provuar se Kuvendi i Shqipërisë, nuk i ishte përgjigjur thirrjes së Presidentit të Republikës për të votuar në seancë plenare vetëm anëtarin e dytë, në mënyrë që Presidenti të shprehej më pas për zgjedhjen e anëtarit tjetër.

Ndërkohë, përgjatë kësaj periudhe, nga data 8 nëntor e në vijim, përfshi dhe diskutimet në seancën plenare, eksponentë të shumicës parlamentare, kanë anatemuar në mënyrën më të padrejtë një nga kandidatët që gjendet në listat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në vakancën për plotësim nga Presidenti, duke hedhur akuza dhe duke përdorur fjalor të papërshtatshëm në adresë edhe të Presidentit të Republikës.

Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përgjatë diskutimeve në publik, por dhe në seancë plenare për sa është bërë publike përgjatë transmetimeve drejtpërdrejt të seancës plenare, edhe pse pranonin faktin që ishin njohur me vendimin e pezullimit të Presidentit, sërish artikulonin pa asnjë mbështetje ligjore dhe pa ndonjë akt se kandidatja e listuar e para konsiderohet e zgjedhur në vakancën që i takon për plotësim Presidentit.

Me këtë argument Kuvendi i Shqipërisë, në seancë plenare përjashtoi nga votimi për anëtare të Gjykatës Kushtetuese zonjën Arta Vorpsi, kandidate e renditur e para në vakancat për plotësim nga Kuvendi. Ky përjashtim nga procesi i votimit, pa ndonjë vendim të Kuvendit të Shqipërisë, përbën një shkelje të rëndë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndaj kësaj kandidateje, pasi në këtë mënyrë asaj iu mohua pa të drejtë nga Kuvendi e drejta për të marrë pjesë në një garë, që kishte konkurruar sipas Kushtetutës.

Kuvendi i Shqipërisë, në kundërshtim me çdo normë kushtetuese, e konsideroi apriori të zgjedhur zonjën Arta Vorpsi në vakancën që i përket Presidentit të Republikës edhe pse Kuvendi në praktikën e tij kishte administruar dhe ishte njohur me vendimin paraprak nr.3535/1 prot, datë 05.11.2019 të Presidentit për pezullimin e procesit.

Këtu, natyrshëm, lind pyetja: a ka të drejtë Kuvendi dhe, aq më pak Kryetari i KED-së, të bëjë një vlerësim të kësaj natyre dhe të konstatojë këtë fakt? Në lidhje me këtë çështje, është me vend të sqarohet se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, si dhe ligji nr.



115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nuk përcaktojnë në asnjë dispozitë të tyre se cili është organi kushtetues që konstaton faktin se një prej kandidatëve konsiderohet i zgjedhur për shkak të mekanizmit zhbllokues.

Në këtë mënyrë, referuar praktikës parlamentare të ndjekur për zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ka përjashtuar pa të drejtë nga votimi kandidaten Arta Vorpsi dhe ka vijuar procesin e votimit vetëm me kandidaten e ngelur në garë për plotësimin e vakancës së shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

Me vendim nr.133, datë 11.11.2019, Kuvendi ka zgjedhur **zonjën Elsa Toska** anëtare të Gjykatës Kushtetuese, si të vetmen kandidatë të ngelur në garë për vakancën e shpallur në datën 12.2.2018.

Pas këtij votimi, edhe për vakancën tjetër, Kuvendi i Shqipërisë sipas vlerësimit të tij ka ngelur me **vetëm një kandidatë**. Me vendimin nr. 134, datë 11.11.2019, Kuvendi ka zgjedhur **zonjën Fiona Papajorgji** anëtare të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e vakancës të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

Në këtë mënyrë, rezulton e provuar:

- Kuvendi i Shqipërisë votoi në seancën plenare dy anëtarë njëherazi të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e dy vakancave;
- Kuvendi i Shqipërisë, me vlerësimet apriori mbi numrin dhe statusin e kandidatëve në listat e administruara, krijoi një problematikë, pasi i mohoi me pa të drejtë kandidates Arta Vorpsi, të drejtën për të marrë pjesë në votim, për të konkurruar në mënyrë të lirë dhe për t’u zgjedhur;
- Kuvendi zgjodhi anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në kushtet kur në garë për secilën vakancë sipas vlerësimit të tij ngeli vetëm 1 kandidat i vlefshëm për përzgjedhje;
- Me nivelin e diskutimit të deputetëve të caktuar në seancë plenare, duke adresuar sulme ndaj kandidatëve në garë dhe Presidentit të Republikës, si dhe me procesin e ndjekur Kuvendi, cenoi rëndë besimin e publikut tek Gjykata Kushtetuese;
- Kuvendi shkeli parashikimet e nenit 179, pika 2 të Kushtetutës dhe neneve 7 e 86 pika 4/c të ligjit nr. 8577/2000, duke votuar zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në kundërshtim me radhën e caktuar;
- Me votimin për dy kandidatë njëherazi dhe zgjedhjen e tyre si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ka cenuar edhe mundësinë e Presidentit të Republikës për zgjedhje, duke ulur numrin e kandidatëve të parashikuar në Kushtetutë nga 3 në 2 kandidatë;
- Me veprimtarinë e tij, Kuvendi humbi shansin të ndihmonte në ruajtjen e integritetit të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse Presidenti i Republikës i bëri thirrje në mënyrë të përsëritur;

- Edhe pse u kërkua në mënyrë shkresore dhe me mesazhe publike të Presidentit, sërish Kuvendi nuk tregoi asnjë shenjë bashkëpunimi ndaj Institucionit dhe kërkesës së Presidentit, në kushtet kur ky bashkëpunim ishte me rëndësi, për shkak se kandidatët në listat e të dyja institucioneve ishin thujse të njëjtit emra;
- Kushtetuta është e qartë. Ajo përcakton radhën e përzgjedhjes së kandidatëve nga secili institucion;
- Vlerësimi apriori i Kuvendit se Presidentit i ka kaluar afati 30-ditor i përzgjedhjes së një kandidati, është i pambështetur në Kushtetutë. Në Kushtetutë, ndryshe nga Kuvendi, për Presidentin e Republikës nuk ka asnjë afat të përcaktuar të detyrueshëm për t'u shprehur.

Presidenti është betuar se do t'i bindet vetëm Kushtetutës dhe për respektimin e saj që në këtë rast është respektimi i radhës së përgjedhjes së anëtarit të dytë, pas Kuvendit, Presidenti, paraprakisht, që prej datës 05.11.2019 ka pezulluar procesin e shqyrtimit të listave dhe dokumentacionit, deri në përmbushjen e këtij kushti. Në këtë mënyrë, vlerësimi i Kuvendit është i pabazuar në fakte, në Kushtetutë dhe në ligj.

## **VII. Gjendja e kandidaturave pas vendimmarrjes së Kuvendit dhe vlerësimi i situatës së krijuar**

Pasi Kuvendi i Shqipërisë është shprehur me vendim për emërimin e dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në seancën e datës 11.11.2019, rezulton se gjendja aktuale e plotësimit të katër vendeve vakant (2 Presidenti dhe 2 Kuvendi) të plotësuara apo në plotësim nga secili organ emërtese paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në këtë tabelë, për qartësi pasqyrohen ish-gjyqtarët dhe koha e përfundimit të mandatit të tyre kushtetues, radha e shpalljes së vakancave dhe emërimit të gjyqtarëve, përkatësisht nga Presidenti dhe Kuvendi i Shqipërisë, si dhe emrat e kandidatëve të emëruar/zgjedhur për secilën vakancë, deri tani.

<b>Radha e</b>	<b>ISH GJYQTAR ËT, MANDATE</b>	<b>VITI I PËRFUND IMIT</b>	<b>ORGANI I EMËRTE SËS QË I PËRKET</b>	<b>KOHA E SHPALL JES SË VAKANC ËS PËR APLIKIM</b>	<b>KANDID ATI I EMËRU AR/</b>	<b>DATA E ENËRI MIT</b>
--------------------	--	--	--	---	---	-------------------------------------

Emëri mit	T E TË CILËVE PLOTËSOHEN	TË MANDATI T	EMËRIMI - ZGJEDH JA		ZGJEDH UR	
1.	Sokol BERBERI	2016	PRESIDENT	07.02.2018	Besnik Muçi	15.10.2019
2.	Vladimir KRISTO	2016	KUVEND	12.02.2018	Elsa Toska	11.11.2019
3.	Altina XHOXHAI	2019	PRESIDENT	04.03.2019		
4.	Bashkim DEDJA	2019	KUVEND	04.03.2019	Fiona Papajorgji	11.11.2019

Në këto kushte, edhe përse Kuvendi ka shkelur radhën e emërimit të përcaktuar nga Kushtetuta, duke emëruar dy gjyqtarë kushtetues njëherazi në datën 11.11.2019 moment ky kur Kuvendi ka shprehur vullnetin e tij, rezulton e provuar tashmë se ka rënë dhe shkak kryesor, mbi të cilin Presidenti i Republikës vendosi pezullimin e procedurës së shqyrtimit të listës dhe dokumentacionit shoqërues për vakancën për plotësim prej tij.

**Në këtë mënyrë, pas datës 11.11.2019 që Kuvendi ka zgjedhur gjyqtarin e dytë Kushtetues, Presidenti i Republikës konstaton rënien e kushtit pezullues dhe në këtë mënyrë Presidenti vijon shqyrtimin e kësaj praktike për t'u shprehur për emërimin e Gjyqtarit Kushtetues, vend vakant ky i shpallur për aplikim nga Presidenti në datën 04.03.2019.**

Siç është parashtruar në hyrje të këtij arsyetimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 132, datë 21.09.2019, ka miratuar "Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019", me këtë renditje:

1.	Arta	Vorpsi	89.642	pikë
2.	Fiona	Papajorgji	88.785	pikë
3.	Elsa	Toska	85.428	pikë
4.	Marsida	Xhaferllari	82.000	pikë

Tre kandidatet të renditura në vendet e para në këtë listë kanë qenë kandidate edhe në listat e Kuvendit të Shqipërisë.

Pasi Kuvendi, në kundërshtim me radhën që dikton Kushtetuta, në datën 11 nëntor 2019, zgjodhi zonjën Elsa Toska dhe zonjën Fiona Papajorgji si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, tashmë në këtë gjendje të procedimit në vakancën e Presidentit rezulton se në garë për konkurrim për plotësimin e vakancës së shpallur nga Presidenti i Republikës, kanë ngelur vetëm 2 (dy) kandidatë:

–**Arta Vorpsi me 89.642 pikë**

–**Marsida Xhaferllari me 82.000 pikë**

Në këto kushte, Kuvendi i Shqipërisë, duke mos iu përmbajtur rregullit për të zgjedhur sipas radhës që dikton Kushtetuta, si dhe duke mos treguar asnjë shenjë për bashkëpunim me Institucionin e Presidentit, me zgjedhjen e dy gjyqtarëve njëherazi, ka cenuar njëkohësisht edhe numrin e kandidatëve që duhet të ketë Presidenti në dispozicion për të emëruar gjyqtarin e ri kushtetues.

Kushtetuta, pohon në mënyrë të qartë një rregull sa të thjeshtë, aq edhe të rëndësishëm sipas të cilit, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese përzgjidhen ndërmjet tri kandidatëve. Pavarësisht se çfarë veprimi (ose mosveprimi) do të bënte Presidenti, së paku, deri në momentin kur ai të vendosë të shprehet me dekret për emërimin e njërit prej tyre, ai duhet të ketë “në dispozicion” 3 kandidatë. Këtë numër Kushtetuta e sheh si një numër objektiv kandidatësh në mënyrë që organi i emërtesës të ushtrojë objektivisht dhe substancialisht të drejtën për të vlerësuar se cili prej tyre është kandidatura më e përshtatshme që mund të ushtrojë funksionin e gjyqtarit kushtetues, sipas vlerësimit të organit të emërtesës.

Ky rregull është i parashikuar në nenin 125 pika 1 e Kushtetutës . Në fjalinë e dytë të kësaj pike pohohet se “Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit”.

Kuvendi, duke zgjedhur dy gjyqtarë njëherazi dhe, duke mos marrë parasysh kërkesën e Presidentit për respektimin e radhës, cenoi numrin e kandidatëve në dispozicion të Presidentit. Nëse Kuvendi në datën 11.11.2019 do të kishte zgjedhur vetëm anëtarin e dytë të Gjykatës Kushtetuese, atëherë Presidenti do të kishte në dispozicion numrin 3 (tre) të kandidatëve të nevojshëm.

Gjithashtu, në këtë procedurë është për t'u evidentuar se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk arriti të përmbushë kërkesat e nenit 7/b, pika 3 të ligjit nr. 8577/2000 ku citohet:

*“3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kritereve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke*

renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton **dy lista** të veçanta, një prej të cilave është me **kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit.**”

**Duke qenë se Presidenti i Republikës kishte për plotësim dy vakanca njëherazi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka mundur të përmbushë këtë kërkesë të ligjit.**

Përveç shumë elementeve të tjerë, në funksion të këtij arsytimi, dy janë elementet kushtetues që shërbejnë në ushtrimin e kompetencës së Presidentit për të emëruar anëtarin e Gjykatës Kushtetuese: elementi i parë, është mundësia objektive që duhet të ketë një organ emërtese për të përzgjedhur **midis tre kandidatëve** dhe elementi i dytë është cilësori **“kandidatë”** i vendosur menjëherë pas shifrës.

Këto dy elemente, njëri sasiore dhe tjetri cilësor, duhet të jenë të pranishëm jo vetëm **në fazën fillestare**, pra atëherë kur fillon të marrë jetë efektivisht kompetenca emëruese e Presidentit (pra në fillim të numërimit të afatit 30-ditor, teksa Kuvendi ka shteruar kompetencën e tij pararendëse për të zgjedhur), por domosdoshmërisht deri në **momentin fundor**, pra momentin e emërimit me dekret të Presidentit.

Të dy elementet janë qartësisht të kuptueshme në brendinë e tyre dhe nuk lënë shkak për dyshim, interpretim apo dyzim kuptimesh. Teksti kushtetues dhe ai i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i ka paraqitur hollësisht secilin prej tyre.

Kështu, për sa i përket shifrës “3”, kuptimi kushtetues është më se i qartë. Në çdo rast Presidenti duhet të ketë efektivisht mundësinë teorike të përzgjedhjes mes 3 alternativave (kandidatëve), qartësisht të dallueshme nga njëra-tjetra.

Për sa i përket termit “kandidat”, Kushtetuta edhe në këtë rast është e qartë. “Kandidat” do të konsiderohet çdo aplikant, i cili së pari, ka kaluar procedurat e verifikim/vlerësim/renditjes prej KED-së, dhe paskëtajt është paraqitur si pjesë e listës tërësore që KED-ja depoziton tek Presidenti.

Kuptohet se “kandidati”, duhet të ruajë këtë cilësi përgjatë gjithë periudhës deri kur Presidenti të shprehet për emërimin përkatës. Por derisa Presidenti të shprehet, gjatë kësaj ndërkohe, mund të ndodhin disa ngjarje të cilat mund t’ia heqin atij paraprakisht këtë cilësi.

Kështu, mund të ndodhin ndërkohë, ngjarje të tilla si p.sh; heqja dorë, vdekja, humbja e shtetësisë shqiptare, verifikimi i kushteve të “dekriminalizimit” sipas ligjit, etj., të cilat bëjnë që ai aplikant të mos jetë më një **“kandidat”** i aftë për t’u emëruar.

Një tjetër ngjarje e ngjashme, por dhe specifike, është edhe rasti kur kandidati në fjalë, është emëruar/zgjedhur, ndërkohë si anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga një tjetër autoritet vendimmarrës (meqenëse në emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese kontribuojnë njëkohësisht 3 autoritete të tilla: President, Kuvend, Gjykatë e Lartë.

Kushtetuta në fakt, është përkujdesur që një “konkurrim” i njëkohshëm në emërim/zgjedhje të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të mos ndodhë.

Ajo ka parashikuar “radhën kronologjike” të emërimit, duke alternuar kompetencën midis Presidentit, pastaj Kuvendit e pastaj Gjykatës së Lartë. Arsyeja ka qenë e thjeshtë: një kandidat në listën e njërit autoritet vendimmarrës, **nëse zgjidhet/emërohet nuk qëndron më si “kandidat” në listën e autoritetit vendimmarrës pasardhës.**

Megjithëse edhe pse ekziston ky urdhërim kushtetues, KED në mosrespektim të këtij rregulli të rëndësishëm kushtetues, mund të dërgojë paralelisht, listat përkatëse drejt autoriteteve vendimmarrëse të ndryshme, të cilat, përgjatë kohës prej 30 ditësh që kanë në dispozicion, të ndodhen përballë rrezikut, teksa një kandidat që ndodhet në listën e tij, të jetë edhe në listën e një autoriteti tjetër, i cili, mund të ketë vepruar ndërkohë, duke e zgjedhur/emëruar *de facto* po atë kandidat.

Me verifikimin e kësaj ngjarjeje, ky aplikant që ndodhet si “kandidat” në listën e një autoriteti vendimmarrës, e humbet këtë cilësi, sepse ai tashmë është zgjedhur **si anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga një autoritet tjetër vendimmarrës.** Do të ishte më së pari jo logjike, që të konsiderohej “kandidat” një anëtar i zgjedhur/emëruar i Gjykatës Kushtetuese.

Këto janë pra, dimensionet juridike të konceptit “kandidat” që përdor Kushtetuta në nenin 125/1 të saj.

Në funksion dhe në harmoni të plotë të parashikimit kushtetues si më lart, është edhe parashikimi i nenit 149/d pika 1 e Kushtetutës . Fjalja e fundit e kësaj pike parashikon se “Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.

**Kjo do të thotë që lista, për sa i përket tre emrave që duhet të përmbajë domosdoshmërisht nuk është e ngurtë.** Ajo mund të plotësohet me kandidatët që pasojnë në rastet kur 1 apo më shumë kandidatë, nga 3 nivelet e sipërme, nuk janë **më të tillë (kandidatë)** për arsye të ndryshme.

Nëse do të ishte ndryshe, Kushtetuta nuk do ta kishte këtë parashikim, madje mund të **pohonte se lista është e mbyllur dhe se emërimi/zgjedhja duhet të bëhet vetëm nga 3 kandidatët që përmbante në fazën fillestare lista, madje të parashikonte se autoritetit vendimmarrës i përcillen vetëm 3 emrat e kandidatëve të parë, kurse kandidatët e tjerë, as që nuk i përcillen autoritetit vendimmarrës.**

Në fakt, neni 125, pika 1 parasheh se lista e përcjellë nga KED-ja mund të përmbajë emrat e më shumë se 3 kandidatëve, por se emërimi/zgjedhja mund të bëhet vetëm ndërmjet 3 kandidatëve të renditur më lart.

Lista “ngurtësohet” vetëm në një rast, por ky rast ka të bëjë me variantin kur autoriteti vendimarrës hesht brenda afatit 30-ditor. Edhe në këtë rast, “ngurtësimi” i listës i referohet vetëm kandidatit të renditur i pari prej KED-së.

Pra, në këtë rast, autoriteti vendimmarrës nuk ka të drejtë të rirendisë hierarkisht 3 kandidatët e parë, sepse në këtë mënyrë do të kompromentohej mekanizmi zhblllokues që parashikon Kushtetuta (i pari i renditur konsiderohet i emëruar në rast heshtjeje).

Në këtë mënyrë, referuar dispozitave të mësipërme, rezulton se Presidenti i Republikës, është përpara kësaj situate të shkaktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe e pasuar me vendimmarrjen e Kuvendit në datën 11.11.2019, ku sot gjendet përpara faktit që aktualisht në garë ka vetëm 2 ( dy) kandidatë për të emëruar njërin prej tyre si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

Duke vlerësuar objektivisht të gjithë situatën e krijuar, ku kjo gjendje ka ardhur për pasojë të veprimeve të organeve të tjera (KED-Kuvend), të cilat prishën radhën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, Presidenti i Republikës, përfundimisht ka vendosur të procedojë me këtë numër kandidatësh, për zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues, për plotësimin e vakancës së shpallur prej tij për aplikim me dekret nr.11133, datë 04.03.2019, pasi ekzistojnë mundësitë për përzgjedhjen e kandidatit të përshtatshëm për t’u emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Edhe pse Kushtetuta dhe ligji, kërkojnë numrin 3 të kandidaturave, Presidenti i Republikës vlerëson, se në rastin konkret, pasja e 2 (dy) alternativave garanton thelbin e së drejtës së zgjedhjes dhe se fryma e Kushtetutës ruhet.

Për Presidentin e Republikës, garantohet kështu hapësira diskrecionare e vlerësimit midis më shumë se 1 kandidati; ndryshe do të ishte një emërim automatik, pra që të drejtën e emërimit ta merrte një organ tjetër që nuk e ka në kompetencë kushtetuese. Për këto shkaqe, vlerëson të operojë me përzgjedhjen mes tyre të kandidatit që do të jetë anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

#### **VIII. Arsyet për përzgjedhjen e kandidaturës të zonjës Marsida Xhaferllari, për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe procedurën e ndjekur**

Presidenti i Republikës, pasi shqyrtoi të gjithë praktikën dhe dokumentacionin e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim ka vendosur që të përzgjedhë kandidaten **Marsida Xhaferllari** për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, kryesisht mbështetur në këto arsye që evidentohen dhe janë vlerësuar edhe më hollësisht nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në vendimet e tij:

Zonja Marsida Xhaferllari, në vitin 1997, është diplomuar “Jurist”, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, me rezultate të shkëlqyera.

Në vitin 2000 zonja Xhaferllari ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe është diplomuar “Magjistrat Gjyqtar” me rezultat “Shumë mirë”.

Zonja Marsida Xhaferllari ka një përvojë të larmishme pune prej më shumë se 20 vjetësh, si Gjyqtar, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit, Drejtor i Përgjithshëm i Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe që prej janarit 2013 në detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Zonja Xhaferllari ka qenë përfaqësuese e Këshillit të Ministrave në shqyrtimin e mbi 50 çështjeve në Gjykatën Kushtetuese, si dhe përfaqësuese e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në çështjet në gjykim pranë kësaj gjykate.

Ushtrimi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Kodifikimit tregon për një kontribut në lidhje me harmonizimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim.

Përgjatë periudhës 2015–2016 zonja Xhaferllari ka qenë eksperte në Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë në Drejtësi, për përfaqësimin e KLD-së, në tryezat e punës të drejtuara nga ekspertë ndërkombëtarë dhe shqiptarë, në hartimin e legjislacionit për gjyqësorin.

Zonja Marsida Xhaferllari ka qenë, gjithashtu, e angazhuar si eksperte dhe pedagoge e jashtme pranë Shkollës së Magjistraturës, në lëndët e së drejtës publike. Gjithashtu, për 5 vjet, ka qenë anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Zonja Xhaferllari është autore edhe e disa botimeve, kryesisht në fushën e të drejtës administrative.

Zonja Marsida Xhaferllari, gëzon integritet të lartë moral, etik dhe cilësi të larta profesionale, të cilat janë kërkesa të domosdoshme dhe në koherencë me besimin që kërkon publiku për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Përgjatë karrierës së saj ka reflektuar aftësi vendimmarrëse dhe bashkëpunimi.

Për më tepër, pas konstituimit dhe fillimit nga funksionimi të organeve të rivlerësimit kalimtar, zonja Xhaferllari në detyrën e Kryeinspektorese së KLD-së, ka treguar një nivel të lartë bashkëpunimi me të gjitha institucionet e reja të sapokrijuara dhe duke ndikuar pozitivisht në nisjen e këtij procesi.



Me zotimin profesional të zonjës Xhaferllari u hartuan dhe miratuan nga Këshilli aktet nënligjore dhe format standarde të komponentit profesional të vlerësimit për gjyqtarët në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar. Përgjatë periudhës shtator 2017 – nëntor 2018 nën mbikqyrjen e zonjës Xhaferllari Inspektoriat i KLD-së, ka hartuar dhe miratuar mbi 100 raporte vlerësimi për gjyqtarë të ndryshëm për efekt të procesit vetting sipas kërkesave dhe drejtimit të këtij procesi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për kandidatin Marsida Xhaferllari është shprehur qartë dhe ka bërë vlerësimet përkatëse në vendimin nr. 111, datë 06.08.2019 për “Lejimin e kandidimit të zonjës Marsida Xhaferllari në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019” dhe në vendimin nr.126, datë 10.09.2019, për “Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës zonjës Marsida Xhaferllari për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019”.

Presidenti i Republikës, pasi iu vu në dispozicion praktika e plotë e KED-së, analizoi edhe dokumentacionin bashkëlidhur.

Përpos kësaj, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës ka qenë i pranishëm në të gjitha mbledhjet e Këshillit dhe është njohur me veprimtarinë e tij.

Nga përmbajtja e dokumentacionit, rezultoi në mënyrë të qartë, se veprimtaria e KED-së, lidhur me këtë kandidaturë, ishte ndjekur në mënyrë jokorrekte dhe, në shumë raste, edhe me shkelje ligjore që synonin qartazi, diskriminimin e kandidaturës në fjalë, me qëllimin fillestar për ta skualifikuar në mënyrë të padrejtë apo edhe atë fundor për ta vlerësuar dhe renditur, me po kaq të padrejtë, sa më poshtë në listë, për ta eliminuar nga mundësia e përzgjedhjes.

Nga informacioni i siguruar dhe veprimtaria e KED-së rezulton se ka pasur një korrespondencë intensive të kandidatës me KED-në lidhur me këtë proces. Presidenti i Republikës, është i kujdesshëm, për të mos ndërhyrë në një veprimtari të brendshme të një organi tjetër siç është KED, por i gjendur para situatave të tilla, i merr ato parasysh në vlerësimin dhe përzgjedhjen që duhet të bëjë.

Ka rezultuar se për këtëandidate, dy anëtare të KED-së, në mënyrë të paarsyeshme, e kanë vlerësuar kandidaten me 0 (zero) pikë. Për asnjë kandidat tjetër nuk ka ndodhur një vlerësim kaq ekstrem.

Vetëm për arsye të këtij vlerësimi diskriminues nga dy anëtarë të KED-së, kandidatja në fjalë, u rendit e 4-ta në radhë në listën fillestare.

Presidenti i Republikës, ka analizuar dokumentacionin edhe në prizmin për të kuptuar shkaqet e vërteta të kësaj sjelljeje të disa anëtarëve të KED-së. Ka rezultuar se ndaj kandidates në fjalë është ndjekur një proces i verifikimit të kushteve të kandidimit, i ndryshëm nga kandidatët e tjerë, me nota të forta diskriminimi.

Përsëri KED-ja ka vlerësuar përfundimisht se zonja Marsida Xhaferllari i plotësonte kushtet e kandidimit.

Nga shqyrtimi i plotë i kësaj çështjeje Presidentit të Republikës i rezulton se qëndrimi i kandidates, në raport me veprimtarinë e KED-së, ka qenë dinjitoz, profesional dhe në lartësinë e kurajës civile që duhet të karakterizojë një anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Edhe pse vazhdimi i kandidimit të mëtejshëm varej nga sjellja paragjyquese e KED-së, edhe pse dukej qartë tendenca diskriminuese e disa anëtarëve, ajo nuk ka bërë kompromis me këto vlera.

Këto janë vlera thelbësore që qëndrojnë në themel të përzgjedhjes që Presidenti i Republikës dhe kushdo autoritet tjetër duhet të udhëhiqet. Posti i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, si edhe të tjera poste të rëndësishme shtetërore, kërkojnë që zyrtari publik të udhëhiqet nga këto vlera.

Janë këto vlera të demonstruara, të cilat japin garanci, se një anëtar i Gjykatës Kushtetuese, nuk do të përthyeret nga presioni shtetëror apo politik apo i çdo natyre, se nuk do të bëjë kompromis në dëm të Kushtetutës dhe se do mbajë lart reputacionin e Gjykatës Kushtetuese.

Janë pikërisht këto vlera dhe cilësi të larta profesionale që ka aspiruar edhe reforma në drejtësi të arrijë përgjatë miratimit dhe zbatimit të saj; ndaj Presidenti i Republikës, pa asnjë mëdyshje, ka bërë këtë përzgjedhje, për vendin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese që i takon atij të përzgjedhë.

Po kështu, Presidenti i Republikës vlerëson shumë faktin se kjo kandidate ka vendosur të kandidojë vetëm për 1 (një) vend vakant nga 4 (katër) vende që kanë qenë të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës (President, Kuvend).

Ky fakt, tregon integritet dhe personalitet, pasi edhe pse ligji nuk e mohon si mundësi për të konkurruar njëherazi në shumë vakanca, kjo kandidatë nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi.

Duke vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin dhe rëndësinë që ka Gjykata Kushtetuese në mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës, Presidenti i Republikës, edhe pse ka ende afat në dispozicion ka vendosur sërish që të shprehet pa vonesë edhe për emërimin e kandidatit të përzgjedhur prej tij, në mënyrë që gjyqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese të fillojnë sa më shpejt detyrën që u është besuar dhe të ushtrojnë sa më shpejt mandatin qoftë dhe për vendime apo çështje që mund të shqyrtohen në kolegjet me tre anëtarë të kësaj gjykate.

Për gjithë sa u parashtrua më sipër, në mbështetje të neneve 93, 125 pikat 1 e 3, 129, 149/d pika 1, 179 pikat 2 e 12, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 7, 7/a pika 4, 7/b, 8 dhe 86, pika 4, shkronja “c” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Presidenti i Republikës në cilësinë e organit të emërtesës ka vendosur që nga dy kandidatët të mbetur në garë nga lista e kandidatëve të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, të përzgjedhë dhe të emërojë zonjën Marsida Xhaferllari, gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**ILIR META**